

Njoftim për Shtyp

Zhvillohet mbledhja e radhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 13.10.2023, ora 15.00 u zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca - kryetar, z. Sandër Simoni – zëvendëskryetar dhe anëtarët: z. Shaban Sinani, z. Maksim Haxhia dhe z. Ilir Dode.

Në përputhje me rendin e ditës të shpërndarë paraprakisht Komisioni verifikoi plotësimin e kriterëve ligjore të 12 kandidatëve, si vijon: Ilir Alushi; Julian Kola; Klodian Gjermani; Margarita Kola; Mirela Murati; Odise Xhelita; Përparim Kalo; Petrit Gaçi; Saimir Kola; Saimir Vishaj; Sokol Dedndreaj; Valbona Greva.

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi:

1. Në zbatim të nenit 19, pika 3, gërma “ç” dhe 117, pika 3 gërma “f” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, t’i dërgohet shkresë organeve tatimore, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve, për kandidatët që rezultuan paqartësi ndërmjet: dokumentave financiarë dhe dokumentave të tjerë që lidhen me punësimin e tyre.

2. Vendimet e kandidatëve për të cilët deri më tani është konstatuar mosplotësimi i një apo më tepër kriterëve ligjore, të parashikuara nga nenet 19 dhe 117 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, do të njoftohen pasi të kenë ardhur përgjigjet nga institucionet të cilave ju është kërkuar informacion nga Komisioni, me qëllim që Komisioni të shqyrtojë

përbushjen e të gjitha kritereve ligjore dhe t'i kthejë kandidatëve një përgjigje të vetme.

Mbledhja e radhës do të caktohet, në varësi të kthimit të përgjigjeve nga institucionet, të cilave ju është kërkuar informacion nga Komisioni.